

KËRKESË
Nr. 3134/1, datë 20.6.2025

**PËR SHPALLJE PËR SHPREHJE INTERESI PËR KANDIDATËT QË KËRKOJNË
TË CERTIFIKOHEN SI NDËRMJETËS TË PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në ligjin nr. 9/2022, “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”, dhe urdhrin nr. 187, datë 4.5.2022, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme mbi paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të personave që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme”, janë përcaktuar rregullat për paraqitjen, trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të personave që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme. Kandidati për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme paraqet shprehjen e interesit dhe dokumentacionin shoqërues, brenda 15 ditëve nga përfundimi i afatit të publikimit. Kandidati për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme, që kërkon të certifikohet si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme, depoziton pranë Ministrisë së Drejtësisë, përmes shërbimit postar ose dorazi, dokumentacionin bashkangjitur:

1. Kërkesë për shprehje interesi për certifikimin si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme;
2. Kopje të mjetit të identifikimit;
3. Certifikatë familjare;
4. Kopje të njësuar të diplomës së arsimit të mesëm të lartë, të lëshuar nga një institucion arsimor i akredituar në Republikën e Shqipërisë, ose diplomë të lëshuar nga një institucion arsimor i huaj, të njohur e të njësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin;
5. Vërtetim nga prokuroria që nuk është nën hetim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit, apo të armëve të shkatërrimit në masë;
6. Vërtetim nga gjykata që nuk është nën gjykim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit, apo të armëve të shkatërrimit në masë;
7. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore të kandidatit dhe për personat e lidhur me të;
8. Vetëdeklarim që nuk ka dënim me masë administrative gjobë ose masë administrative që detyron subjektin të ndalë një sjellje të caktuar, praktikë pune apo biznesi, si dhe të mos e përsërisë në të ardhmen, për shkelje të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave, të paktën jo më herët se 6 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës;
9. Certifikatë për përfundimin me sukses të programit të detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme;
10. Dokument që provon zotërimin e gjuhës shqipe, të lëshuar nga autoritetet kompetente sipas legjislacionit në fuqi (për shtetasin e huaj).